



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 362, Datë 07.12.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI “MIRESHI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.9 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “a”, dhe 38, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1 gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2360/7 prot., datë 06.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Mireshti” me fuqi të instaluar 1.9MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2360 prot., datë 02.11.2023 ka paraqitur aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mireshti”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.9 MW.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 321, datë 14.11.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Mireshti”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.9 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.11.2023 dhe 16.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2360/3 prot., datë 17.11.2023, dhe me e-mailin me nr. 2360/5 prot., datë 05.12.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2360/4 prot., datë 23.11.2023, nr. 2360/6 prot., datë 05.12.2023 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “GERTI” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.1 gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 2.1, gërmat a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 6 vjet e 4 muaj nga periudha e mbajtjes së miratimit dhe periudha e mbetur për licencim është 42 vjet e 8 muaj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga nga Hec “Mireshi”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.9 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**